

Vendim nr. 264 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Marjana Semini, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 11 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **TEFIK BOGDANI**, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Xhemal Gazidede.

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.**

Shfuqizimi i vendimeve nr. 6 (250), datë 29.01.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2024-2362, datë 04.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga gjashtë trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit R.B., i cili përfiton 1/6-ën pjesë të trashëgimisë së tij. Trashëgimtarët me prokurën e datës 05.10.2009 kanë caktuar kërkuesin si përfaqësues të tyre gjatë procesit gjyqësor.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me vendimin nr. 463, datë 31.5.1994, ka vërtetuar faktin juridik se trashëgimlënësi R.B. ka qenë pronar para vitit 1945 i disa pasurive, konkretisht tokë arë me sipërfaqe 2650 m² të parcelës “Fushë”; tokë arë me sipërfaqe 900 m²; tokë livadh me sipërfaqe 500 m²; tokë arë me sipërfaqe 1700 m²; tokë livadh me sipërfaqe 1470 m², të ndodhura në fshatin Rrajcë-Sutaj, Rrajcë-Fushë, Rrajcë-Skënderbe dhe fshatin Bardhaj.

3. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Librazhd, me vendimin nr. 75, datë 12.07.1995 (*vendim nr. 75/1995*), i ka njohur ish-pronarit R.B. pronësinë për pasuritë e sipërcituara dhe në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” është vendosur kompensimi me obligacione për sipërfaqen 6420 m².

4. Kërkuesi, si trashëgimtar, i është drejtuar AKKP-së për kompensimin në të holla. AKKP-ja, me vendimet nr. 533, datë 15.08.2011 dhe nr. 591, datë 05.04.2013, ka vendosur mosmiratimin e kërkesave të paraqitura për kompensim në të holla nga fondi i vitit 2011 dhe 2012 të subjekteve të shpronësuara (trashëgimtarëve të tyre), për shkak të pamjaftueshmërisë së këtij fondi. Gjithashtu, me shkresën nr. 54/1 prot., datë 21.01.2014, AKKP-ja ka njoftuar kërkuesin për mosmiratimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së fondit për kompensim në të holla të vitit 2013, pasi sipas AKKP-së vendimi për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe të kompensimit e kishte më të vonë se data e vendimit të fundit fitues.

5. Agjencia e Trajtimit të Pronave (*ATP*), në zbatim të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*) dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar (*VKM nr. 223/2016*), ka përfunduar procesin e vlerësimit ekonomik të vendimeve përfundimtare që janë shprehur për njohjen e së drejtës së kompensimit për vitin

1995, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit në të gjithë vendin dhe i ka bërë publike ato në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 14, datë 08.05.2017, si dhe në faqen zyrtare të ATP-së.

6. Kërkuesi në datën 31.05.2017 i është drejtuar me kërkesë ATP-së, e cila me shkresën nr. 2689/2, datë 06.07.2017 e ka njoftuar se pas verifikimit të dokumentacionit ka rezultuar se ish-pronarit R.B., me vendimin nr. 75/1995 të KKKP-së, i është njohur sipërfaqja 300 m² dhe e drejta e kompensimit për sipërfaqen 6420 m². Sipas ATP-së, bazuar në nenin 6, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2015, metodologjia e vlerësimit bazohej në zërin kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit. Në rastin konkret zëri kadastral i origjinës së pronës kishte qenë tokë bujqësore për sipërfaqen 4950 m² dhe tokë livadh për sipërfaqen 1470 m². Referuar dokumentacionit hartografik, zëri kadastral aktual është tokë truall dhe referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 89/2016) vlera e tokës bujqësore në zonën kadastrale ku ndodhet ajo është 174 lekë/m², ndërsa e tokës livadh është 83 lekë/m², pra vlerësimi financiar për sipërfaqen e pronës për të cilën është njohur e drejta e kompensimit është 983 310 lekë. Në përfundim ATP-ja është shprehur se të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë bujqësore, livadh, pyll dhe kullotë, përfitojnë kompensim fizik nga fondi i tokës sipas nenit 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 133/2015.

7. Kërkuesi në datën 08.09.2017 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padi për shfuqizimin e aktit administrativ nr. 2689/2 prot., datë 06.07.2017 të ATP-së dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë kompensimin financiar në të holla për sipërfaqen 6.420 m² me çmimin sipas zërit kadastral truall dhe jo tokë bujqësore. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 6 (250), datë 29.01.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2362, datë 04.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk i referohej asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

8. Kërkuesi në datën 17.09.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor të drejtim të:
- 9.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe jo në seancë në dhomën e këshillimit.
- 9.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi skema e parashikuar nga akti administrativ nr. 2689/2, datë 06.07.2017 i ATP-së trajton në mënyra të ndryshme të njëjtën kategori pronarësh, pasi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 pronarët janë kompensuar në vlera më të ulëta. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura se prona ishte truall dhe jo tokë bujqësore.
- 9.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vlerësimi financiar është i gabuar dhe bie ndesh me nenin 6, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2015, pasi është marrë në bazë të përcaktimit në zërin kadastral të tokës të vitit 1944 kur prona nuk ishte shtetëzuar. Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë e kanë anashkaluar këtë shkelje të rëndë procedurale.
- 9.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs, në drejtim të ndryshimit kadastral të pronës. Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal duke mos analizuar shkaqet e ngritura në rekurs. Ajo nuk ka arsyetuar për qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila nuk ka respektuar vendimin nr. 75/1995 të KKKP-së, i cili nuk është kundërshtuar dhe konsiderohet si vendim i formës së prerë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk është shprehur në vendim në lidhje me momentin e lindjes së të drejtës për kompensimin financiar, e cila është fituar në vitin 1995 dhe nuk është realizuar akoma. Gjykata e Lartë e ka zbatuar gabim ligjin material dhe procedural për kompensimin financiar të pronës. Për shkak të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë është cenuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë.

12. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe pasi ka paraqitur pretendimet e tij në rekurs, për rrjedhojë ai ka shteruar mjetet juridike efektive dhe i vetmi mjet në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 04.06.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.09.2024, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka parashtruar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u

gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

16. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore me praninë e palëve u përket vetëm kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vetëm fakti i shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt dhe kërkuesi nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për pretendimin e tij, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, duke argumentuar se: i) pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 ish-pronarët janë kompensuar në vlera më të ulëta, për shkak të formulës të parashikuar nga ligji për kompensimin financiar sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit; ii) gjykata administrative nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura për zërin kadastral të pronës në momentin e shpronësimit, e cila ka qenë truall dhe jo tokë bujqësore.

19. Në lidhje me kërkimin e parë, për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve për shkak të zbatimit të formulës së kompensimit financiar, Kolegji konstaton se nga përmbajtja e materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të çështjes rezulton se ATP-ja dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke u bazuar në dokumentacionin përkatës, kanë vlerësuar se në momentin e shpronësimit, sipas zërit kadastral, prona rezultonte tokë bujqësore dhe vlerësimi i saj është bërë sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 133/2015. Kolegji evidenton se dispozita ka qenë objekt shqyrtimi në Gjykatë, e cila ka vlerësuar se respekton standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente konkrete dhe të mjaftueshme kushtetuese për të mbështetur pretendimin e tij, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Për kërkimin e dytë se gjykata administrative nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura në lidhje me zërin kadastral të pronës në momentin e shpronësimit, Kolegji vlerëson se në thelb argumentet lidhen me vlerësimin e provave e fakteve në funksion të vlerësimit financiar të pronës, të cilat janë në juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për pretendimet e tjera lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, në thelb kërkuesi ka parashtruar të njëjtat argumente, të cilat lidhen me vendimet/qëndrimin e gjykatës administrative dhe të Gjykatës së Lartë për vlerësimin financiar të pronës së tij. Për këtë qëllim, Kolegji do të analizojë pretendimet në drejtim të respektimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata administrative dhe Gjykata e Lartë kanë anashkalluar shkeljen e rëndë procedurale lidhur me vlerësimin financiar të pronës, i cili është bërë sipas zërit kadastral të tokës të vitit 1944 kur prona nuk ishte shtetëzuar. Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal, duke mos analizuar shkaqet e ngritura në rekurs që lidheshin me mosrespektimin e vendimit nr. 75/1995 të KKKP-së, që konsiderohet si vendim *quasi gjyqësor*.

23. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Funkcioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrар, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata

nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata kompetente për të shqyrtuar ankimet ndaj vlerësimit financiar, është vënë në lëvizje pas padisë së kërkuarit duke kundërshtuar në thelb vlerën e përcaktuar të kompensimit. Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim procedurën për kompensimin dhe mënyrën e disponimit të organeve administrative. Referuar dokumentacionit ligjor, vendimit nr. 463, datë 16.06.1994 të Gjykatës së Rrethit Librazhd, është konstatuar se zëri kadastral i origjinës së pronës ka qenë tokë bujqësore për sipërfaqen 4950 m² dhe tokë livadh për sipërfaqen 1470 m². Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, vlerësimi financiar për sipërfaqen e pronës për të cilën është njohur e drejta e kompensimit me vendimin nr. 75/1995 të ish-KKKP-së, Librazhd është bazuar në hartën e vlerës në fuqi. Bazuar në rrethanat e faktit e të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar të ligjshme veprimtarinë për kryerjen e vlerësimit financiar të vendimit nr. 75/1995 të KKKP-së, Librazhd. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

27. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e tyre vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë nuk rezultojnë të jenë të paqarta ose të kenë mbajtur qëndrim formal. Vendimi i Kolegjit Administrativ, megjithëse me arsyetim të kufizuar, ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit, duke pasqyruar të dhënat e palëve, objektin e gjykimit, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, arsyetimin e përmbledhur të Gjykatës Administrative të Apelit, shkaqet e argumentet e paraqitura nga kërkuari në rekurs, si dhe i ka dhënë përgjigje pretendimeve të rekursit, duke i vlerësuar si të paargumentuara sipas kërkesave të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Kolegji vlerëson se në përmbajtje të vendimeve nuk rezulton të ketë ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik në lidhje me zbatimin e ligjit material dhe procedural, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë dhe të ishte i tillë

që ta bënte gjykimin të padrejtë. Për më tepër në këtë drejtim duhet theksuar se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, gjë e cila është detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.